



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KODI: 4.1.12.B

PROGRAMI I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE DHE I LETËRSISË

PËR KLASËN E 12-të

TIRANË, PRILL 2010

Programi i lëndës së gjuhës shqipe dhe i letërsisë, klasa e 12-të, përmyll ciklin e arsimit të mesëm dhe është vazhdim logjik dhe integral i programit të klasës së 10-të dhe të 11-të. Për rrjedhojë, ai respekton parimet mbi të cilat janë ndërtuar programet në vitet paraardhëse, si:

- integrimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë;
- rimarrja e njohurive, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato;
- gjuha dhe letërsia përbëjnë themelet në procesin e të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore.

Programi i klasës së 12^{te} mundëson përmbushjen e standardit për aftësinë e të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të vështruarit. Ai realizon misionin e lëndës, në drejtim të pasurimit të përvojave dhe të interesave të nxënësve, nëpërmjet përdorimit të gjuhës e të letërsisë. Për këtë, nxënësit do të *përdorin* dhe do të *përballen* me të gjitha format e produkteve të shkruara ose jo të shkruara, si dhe të produkteve të ndryshme mediatike. Pra, ata do të mësojnë t'i trajtojnë këto produkte si tekste që mund të lexohen, të kuptohen dhe të ndërtohen.

Teksti është element i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm i lëndës së gjuhës shqipe dhe i letërsisë, pasi nëpërmjet tij do të realizohen gjithë objektivat e programit. Mësimi i gjuhës dhe i letërsisë bëhet mbi të gjitha nëpërmjet **rritjes së kompleksitetit të veprave dhe të teksteve** me të cilat do të përballet nxënës/i,-ja nga klasa në klasë. Tekstet janë përzgjedhur gjithashtu edhe në përputhje me zhvillimin emocional dhe mendor të nxënësve në klasa të ndryshme. Janë pikërisht këto tekste dhe shkalla e vështirësisë së tyre në rritje, të cilat bëjnë që edhe objektiva të njëjtë në formulim me vitin paraardhës, të trajtohen në nivele dhe mënyra të ndryshme.

E rëndësishme në përvetësimin e aftësive të të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të vështruarit është që të kuptohet se:

- a) aftësitë në përdorimin e gjuhës dhe trajtimin e letërsisë rriten dhe ndërlikohen, në qoftë se gjuha dhe letërsia, gjithnjë e më shumë, përdoren në mënyrat dhe format e tyre komplekse që bart sistemi gjuhësor dhe letrar. Për këtë, nxënësit duhet të angazhohen në tekste dhe bashkëbisedime që janë të pasura me ide dhe shprehësi dhe duke u rritur në shkallën e vështirësisë së tyre në mënyrën se si janë shtjelluar;
- b) përdorimi i gjuhës është një proces aktiv për ndërtimin e domethënies a kuptimit; një dëgjues (lexues) lidh (shfrytëzon) lidh njohuritë e mëparshme për të kuptuar atë që thonë të tjerët;
- c) gjuha zhvillohet në një kontekst social dhe kulturor. Megjithëse ne e përdorim gjuhën për qëllime dhe veprimtari personale, ky proces lidhet edhe me të tjerët, duke u shndërruar kështu një akt ndërpersonal. Ne jemi dëgjues receptues aktivë për ata që krijojnë tekstet e shkruara, të folura dhe vizuale, të tjerët dëgjojnë mendimet tona dhe lexojnë shkrimet tona;
- d) gjuha është mjet dhe ekzistencë e qenies, madje e kuptuar edhe si një proces i hapur, ku marrja e përvojës së teksteve, është e ndërlidhur edhe me dhënien e përvojës personale;

- e) nxënësit realizojnë të nxënit jo duke i shtuar aftësitë një nga një në “bagazhin” e tyre, por nga përdorimi dhe zbulimi i gjuhës në përmasat e saj të shumta (në vlera dhe në funksione).

- **Drejtimet thelbësore që përcaktojnë ndryshimin e programeve sipas klasave**

Së pari, programi merr parasysh se të gjitha konceptet, aftësitë dhe njohuritë trajtohen në tekste të llojeve të ndryshme (letrare dhe joletrare), të cilat përfaqësojnë periudha të ndryshme kohore dhe letrare, nëpërmjet formave të ndryshme të ligjërimit.

Së dyti, tekstet/veprat për secilën klasë janë zgjedhur dhe janë rekomanduar në përshtatje me moshën dhe njohuritë e programit, si dhe me aftësitë përthithëse të nxënës/it,-es. Kjo do të thotë që aftësitë, konceptet dhe njohuritë rimerren në tekste me nivel të ndryshëm vështirësie.

Së treti, konceptet dhe njohuritë janë trajtuar duke marrë parasysh nivelet e taksonomisë së Blumit. Në klasën e 10-të zë vend më shumë njohja dhe të kuptuarit, në klasën e 11-të analiza dhe interpretimi i tyre dhe në klasën e 12-të sinteza, përgjithësimi dhe vlerësimi i teksteve letrare dhe joletrare. (Kjo nuk pengon ndërthurjen e niveleve). Këtu nënkuptojnë edhe rimarrjen, e cila nuk është riprodhim mekanik, por vendosja e tyre në një kontekst të ri.

Formulimi i pyetjes dhe i përgjigjes së nxënës/it,-es varet nga shkalla e njohjes me tekstin, nga mënyra se si dijet përpunohen në klasë, duke operuar me pyetje që nxiten nga strategji të ndryshme të të lexuarit, për të kuptuar e për të analizuar tekstin, por edhe për të ndërtuar kuptime të reja, të pasuruara nga përvoja letrare dhe jetësore e tij/saj në atë nivel shkollimi.

Së katërti, dihet mirë, tashmë nga përvoja e të nxënit, se të shkruarit, p.sh.: vetëm të një eseje argumentuese në një klasë, rreth një teksti/vepre të caktuar nuk i jep nxënësit aftësitë e duhura për të thënë që ky nxënës e ka përvetësuar shkrimin e kësaj eseje si strukturë dhe formësim shkrimor, ku ndërtohen dhe renditen argumentet për ta mbrojtur një ide apo kundërshtuar, aq më pak ta kthejë atë në *shprehi*. Po kështu, të ushtruarit në të shkruar për një periudhë kohore të caktuar, brenda një nivel shkollimi, nuk krijon mundësinë që nxënës/i,-ja të arrijë standardin e të shkruarit, qartë dhe me shprehësi. Për këtë themi se trajtimi, zbërthimi, komentimi apo edhe të shkruarit e një eseje, nuk është i njëjtë si për nxënësin e klasës së 10-të dhe atij të klasës së 11-të e 12-të.

Pritshmëritë e nivelit të performancës mbi të njëjtin tekst në klasa të ndryshme ndryshon, ashtu sikurse disa tekste janë më të përshtatshme për nxënës/in,-en e klasës së 10^{te} e disa shumë më të përshtatshme për atë të klasës së 12-të. (I njëjti argument është i vërtetë për të gjitha llojet e aftësive që ky program synon përgjatë shkollës së mesme).

Aftësitë janë parë si *procese* dhe jo si *pika të izoluara njohurish*, madje si procese të hapura, që përplotësohen në çdo tekst. Kjo nënkupton që të gjitha aftësitë që kanë të bëjnë me format e ndryshme të ligjërimit, janë procese të cilat duhen rimarrë çdo vit në mënyrë që t’i afrohemi përvetësimit të plotë dhe përfundimtar të tyre.

Në këtë nivel shkollimi përvetësimi i ligjërimit të folur dhe të shkruar kërkohet të kthehet në veprimtari të ndërjegjshme, që të ushtrorë aftësitë si shprehi të ngulitura. Në praktikë ai realizohet përmes analizës së akteve të ligjërimit të folur dhe të shkruar, përmes analizës së teksteve letrare e jo letrare. Kjo do të thotë se në gjimnaz kërkësat gjuhësore janë kryesisht kërkësa që lidhen me stilistikën gjuhësore dhe letrare

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda ka për synim të zhvillojë tek nxënësit:

- të lexuarit dhe të shkruarit e logjikshëm dhe kritik për t'i përgatitur ata për të ndërmarrë sfida dhe përgjegjësi gjatë jetës në të gjitha situatat;
- respektin dhe vlerësimin për përdorimin e gjuhës së shkruar dhe të folur, në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme;
- vetëdijen për vlerat e teksteve letrare dhe joletrare për të pasuruar perceptimet, për të rritur sensin (drejtimin/kahen) e identitetit kulturor dhe për të krijuar përvoja për kënaqësi estetike;

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të gjimnazit, në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, nxënësit duhet:

- të zotërojnë në një nivel të kënaqshëm njohuritë e tyre për gjuhën shqipe, letërsinë dhe komunikimin, duke përdorur koncepte të përshtatshme;
- të zhvillojnë mendimin kritik, të pavarur dhe personal, nëpërmjet mundësive të përditshme për të lexuar, për të shkruar, për të folur, për të vështruar dhe për të dëgjuar tekste të formave të ndryshme letrare, joletrare e mediatike;
- të respektojnë natyrën rekursive (përsëritëse) të artit, të përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme, për qëllime dhe audienca të larmishme;
- të familjarizohen me konceptet kryesore të letërsisë, për të vlerësuar domethënien e teksteve, e në mënyrë të veçantë shenjën letrare të tyre, duke u nisur nga kultura e tyre, me qëllim ndërtimin e identitetit dhe të kulturës individuale;
- të njihen me vepra të shkrimtarëve përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe botërore;
- të zhvillojnë të menduarit kritik e krijues, analitik dhe sintetik, duke zgjeruar njohuritë e përgjithshme në letërsi, si dhe mprehtësinë e të shijuarit të shprehësisë artistike e imagjinuase, për të ndërtuar imazhin e tyre për botën;
- të fitojnë aftësi analitike për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekstet e tyre për një larmi funksionesh që bart teksti;
- të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur e të rrjedhshëm, si dhe për të kuptuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- të shkruajnë me një përqendrim të qartë, organizim koherent, me të dhëna dhe hollësi të mjaftueshme për një sërë audiencash, qëllimesh dhe kontekstesh;
- të pasurojnë dhe të ngulisin shprehitë folëse, shkruese, lexuese në përshtatje me objektin e ligjërimit;
- të flasin në mënyre logjike dhe të qartë, por edhe ndikuese për audienca, qëllime, situata dhe kontekste të ndryshme;

- të jenë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh dhe në situata të ndryshme;
- të vështrojnë, të vlerësojnë dhe të reagojnë ndaj teksteve dhe burimeve të shkruara, jo të shkruara dhe elektronike;
- të përzgjedhin dhe të interpretojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi, pa asnjë kufizim kohor dhe hapësinor.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

34 javë x 4 orë/javë = 136 orë vjetore

16 orë janë planifikuar për përgatitje për Maturën Shtetërore

TË LEXUARIT

Linja1. Ndërgjegjësimi fonologjik

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e njohurive fonologjike të domosdoshme për të lexuar saktë dhe bukur fjalën. Ai/ajo i përdori këto njohuri gjatë procesit të të lexuarit të teksteve të ndryshme¹, për të shqiptuar saktë fjalën dhe për qëllime shprehësie. Gjithashtu, nxënës/i,-ja respektoi përdorimin e theksit të fjalës e të njësisë më të mëdha se fjala, zbulon dhe interpreton shenjat letrare, në të gjithë hapësirën e tekstit.

Linja	Objektiva
Ndërgjegjësimi fonologjik²	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të respektojë strukturën fonetike të fjalës; - të artikulojë fjalët e tekstit të dhënë në përputhje me njohuritë e fonetikës për strukturën fonetike të fjalës (p.sh.: rastet e takimit të dy bashkëtingëlloreve që në pamje të parë krijojnë një shkronjë të përbërë, rastet e takimit të dy shkronjave të njëjta dhe rastet kur drejtshqiptimi nuk përputhet me drejtshkrimin); - të praktikojë elementet e shprehësisë tingullore të shqipes (shqiptimi letrar, theksi, intonacioni, organizimet tingullore, imitimet dhe simbolizmi tingullor); - të respektojë përdorimin e theksit të fjalës (flámur-flámuj,

¹ Tekste të ndryshme nënkupton tekste letrare dhe jolettrare, të shkruara, të folura dhe pamore.

² Objektivat e kësaj linje janë kërkesa të përhershme, për të realizuar drejtshqiptimin e shqipes standarde, pa cënuar vlerat letrare të varianteve të gjuhës shqipe.

	flamúr-flamúrë), të frazës dhe të fjalisë; - të interpretojë shenjat letrare, në të gjithë hapësirën e tekstit.
--	--

Linja 2. Njohuritë mbi fjalën

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit dhe përdorimin drejt të koncepteve mbi fjalën. Ai/ajo zbulon origjinën e fjalës për të kuptuar domethënien e teksteve. Interpreton kuptimet e dyta si pasuri gjuhësore brenda situatës tekstore, si dhe vlerëson kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst. Ai/ajo analizon praninë e parateksteve, interteksteve dhe hiperteksteve. Për të realizuar procesin e analizës dhe të interpretimit, nxënës/i,-ja përdori tekste të marra nga burime të ndryshme.

Linja	Objektiva
Njohuritë mbi fjalën	Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të zbulojë kuptimin me të cilin del fjala, në kontekstin që përdoret; - të zbulojë motivimin strukturor dhe kuptimor të fjalës si një mjet për të kuptuar domethënien e tekstit; - të dallojë kufijtë e fjalës (fjala, fjala me strukturë të hapur dhe frazeologjia); - të interpretojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst letrar; - të interpretojë shprehësinë e fjalës për sendërtimin e tekstit; - të interpretojë shprehësinë e fjalës për të kuptuar dhe shqiptuar ligjërimin letrar të varianteve të gjuhës shqipe; - të interpretojë kuptimet e <i>dyta</i> të fjalëve si pasuri gjuhësore e shqipes brenda situatës dhe hapësirës tekstore; - të dallojë kuptimet e figurshme si njësi gjuhësore nga përdorimet e figurshme si njësi të stilistikës letrare; - të vlerësojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst.

Linja 3. Rrjedhshmëria

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja zhvilloi të kuptuarit, si dhe të shprehurit e konceptit për rrjedhshmërinë (shpejtësi, saktësi, shprehësi dhe kuptimësi) dhe shqiptimin e fjalëve në tekste të ndryshme. Ai/ajo ushtrohet në të lexuarit rrjedhshëm dhe në mënyrë të kuptimshme të teksteve të ndryshme, të marra nga burime të ndryshme.

Linja	Objektiva
-------	-----------

Rrjedhshmëria³	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë rrjedhshëm (<i>me shpejtësinë që kërkon lloji i tekstit, me saktësi, me shprehësi dhe me kuptimësi</i>) dhe me shqiptimin e duhur tekste të ndryshme; - të realizojë leximin shprehës në përshtatje me llojin e tekstit; - të ushtrojë leximin e qëllimshëm e të rrjedhshëm të teksteve të llojeve të ndryshme.
----------------------------------	--

Linja 4. Strategjitë e të lexuarit

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja përdor strategjitë e të lexuarit, bën identifikimin e veçorive të teksteve, përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit. Ai/ajo vlerëson të veçantën e një teksti letrar, si dhe mënyrat në të cilat organizimi strukturor i një teksti mbështet ose kundërshton qëllimin a domethënien e tij. Gjithashtu, zbulon dhe vlerëson pozicionin e autor/it,-es duke ndjekur rrjedhën dhe koherencën e argumenteve.

Linja	Objektiva
Strategjitë e të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojë strategji të tilla të të lexuarit, si: strategjia e brainstorm-it, e hartës së tekstit, e problemzgjdhjes, e organizuesit grafik, e përmbledhjes, të diagrami të Venit, mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët, e parashikimit që janë efektive për të kuptuar tekste të ndryshme; - të përdorë tabela, diagrame, harta etj., për të memorizuar informacionin dhe për të monitoruar procesin e të kuptuarit; - të përdorë njohuritë e mëparshme, përmbajtjen dhe veçoritë organizative e grafike të teksteve të ndryshme për të bërë parashikime, për t'i rishikuar e për t'i verifikuar ato, gjatë dhe pas leximit të tyre; - të bëjë pyetje analitike, sintetizuese e vlerësuese përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit; - t'u përgjigjet pyetjeve analitike, sintetizuese e vlerësuese në mënyrë logjike përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit; - të përdorë informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime; - të dallojë prirjet (anësitë) dhe stereotipet në llojet e ndryshme të teksteve;

³ Objektivat e kësaj linje janë të përhershme për të realizuar të lexuarit e kuptimshëm.

	<ul style="list-style-type: none"> - të dallojë informacionin thelbësor nga ai jothelbësor; - të përdorë parafrazimin dhe aftësitë organizuese për të parafrazuar informacionin e marrë nga tekste të llojeve të ndryshme, në një linjë të logjikshme duke ruajtur idenë e autorit/autore; - të bëjë përmbledhjen e një teksti; - të vlerësojë të veçantën e një teksti letrar si i tillë; - të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: personazhet, temën, problemzgjdhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera; - të ndjekë koherencën dhe kohezionin e argumenteve për të zbuluar pozicionin e autorit në një tekst bindës; - të vlerësojë mënyrat në të cilat organizimi strukturor i një teksti (p.sh.: sekuenca, problemzgjdhja, krahasimi, përshkrimi, lidhja e ndërmjetme etj.), mbështet ose kundërshton qëllimin a domethënien e tij; - të vlerësojë stilin e autorit në tekste të ndryshme; - të vlerësojë efektivitetin e teknikave që autori përdor për të mbështetur pozicionin e tij.
--	--

Linja 5. Pasurimi i fjalorit

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja përdor materiale udhëzuese dhe hulumton fjalët e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin. Ai/ajo shfrytëzon për qëllime vetjake, përdorime të gjuhës së figurshme të teksteve letrare, si dhe ndërton fjalorin e një teksti letrar sipas modeleve të fushave të ndryshme të studimit. Gjithashtu, vlerëson figurshmërinë e përdorur në tekste të ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë, si dhe pasurinë shprehëse të gjuhës shqipe nëpërmjet dukurive gjuhësore.

Linja	Objektiva
Pasurimi i fjalorit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme; - të rritë kompetencën ligjërimore e leksikore me fjalë të reja, me njësi frazeologjike, me fjalë të urta, fjalë fluturake, fjalëshpejtat (kalamburet) për të pasuruar fjalorin dhe për të rritur forcën shprehëse të ligjërimit të tij/të saj; - të përdorë gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, hiperonimia/hiponimia për larmi, por edhe thukësi shprehjeje; - të analizojë figurshmërinë e përdorur në tekste të

	<p>ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë (fonetike, morfologjike, leksikologjike, sintaksore), për të pasuruar fjalorin;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shfrytëzojë përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme dhe vepra letrare; - të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë nga i nënkuptuari për të interpretuar forcën e fjalës; - të analizojë përdorimin e gjuhës së figurshme në tekste të ndryshme dhe vepra letrare për të pasuruar fjalorin vetjak; - të ndërtojë fjalorin e një teksti letrar duke përdorur modele fjalorësh të fushave të ndryshme studimi; - të ndërgjegjësohet për pasurinë shprehëse të gjuhës shqipe në rrafshin leksikor e semantik, përmes krijimit të fjalëve e të kuptimeve të reja, përmes futjes në përdorim të fjalëve dialektore me vlera shënuese e shprehëse; - të pasurojë fjalorin me fjalë të huaja të domosdoshme, duke mënjanuar fjalët e huaja të panevojshme.
--	--

Linja 6. Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja përdor njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar tekstin. Ai/ajo zbulon dimensione kuptimore të caktuara, si: parateksti, interteksti, hiperteksti dhe mbitekstit, pra të gjithë rrejtën tekstologjike, duke vendosur në plan krahasues tekste të ndryshme letrare. Nxënës/i,-ja zbulon tonin dhe atmosferën e veprës nëpërmjet fjalëve të përzgjedhura nga autor/i,-ja, si dhe të veçantat e të përbashkëtat mes teksteve të traditës dhe bashkëkohore, duke i krahasuar ato. Gjithashtu, nxënës/i,-ja interpreton një vepër në drejtim të arritjes artistike gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike.

Për të zhvilluar aftësitë e të kuptuarit të tekstit, ai/ajo përdor tekste të marra nga burime të llojeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë tekstin (letrar dhe joletrar) si forma të larmishme të ligjërimit; - të tregojë sesi teksti pasqyron artistikisht marrëdhënie historiko-shoqërore të një periudhe kohore të caktuar, si dhe marrëdhënie specifike të sistemit letrar; - të analizojë në plan krahasues tekste të ndryshme për të zbuluar dimensione kuptimore të caktuara mes tyre (parateksti, interteksti, hiperteksti, mbiteksti); - të identifikojë karakteristika të kompozicionit në tekste të ndryshme;

	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë karakteristika përmbajtësore të teksteve (tema, tematika, motivi, karakteret); - të interpretojë tiparet kryesore të sendërtimit artistik; - të vlerësojë gjuhën e figurshme të një teksti përmes analizës; - të ndërtojë kuptimin e tekstit duke u nisur nga një seri treguesish vizualë dhe abstraktë; - të rindërtojë tekstin sipas një këndvështrimi vetjak, duke e pasuruar materialin me përvojën e tij/saj jetësore dhe kulturore⁴; - të zbërthejë nëntekstin e një teksti letrar të caktuar; - të analizojë nëntekstin e një teksti letrar të caktuar; - të analizojë stilin e autorit/autore në tekste të ndryshme; - të dallojë faktin nga opinioni duke përdorur informacione nga teksti, argumente koherente dhe këndvështrimin vetjak; - të dallojë koherencën e argumenteve në tekste të ndryshme; - të zbulojë qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe ndaj lexuesit të cilit i drejtohet (përmes një vepre të plotë apo jo të tillë); - të bëjë dallimin ndërmjet përmbledhjes së tekstit dhe qëndrimit kritik ndaj tij; - të zbulojë sesi përdorimi i fjalëve të autorit krijon tonin dhe atmosferën e përgjithshme të veprës; - të interpretojë një vepër në drejtim të arritjes artistike gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike; - të analizojë sesi zgjedhja e fjalëve ndikon në zhvillimin e temës ose qëllimit të saj; - të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese midis një teksti të traditës letrare dhe një shkrimi bashkëkohor, duke i vendosur në marrëdhënie krahasuese; - të verifikojë tiparet kryesore të substancës së tekstit letrar; - të interpretojë thelbin e gjuhës së figurshme që ndikon tek emocionet dhe perceptimi i mesazhit autorial në tekste të gjinive të ndryshme; - të ndërjegjësohet për hapësirën e përdorimit të leksikut specifik, të fjalëve të lashta, të dialogut dhe përshkrimit si individualizim i kohës dhe i personazheve.
--	---

Linja 7. Kërkimi

⁴ Ndërtimi dhe rindërtimi përbëjnë një aktivitet të mirëfilltë individual, sepse leximi ndryshon në varësi të individit, pra “lexohet” individualisht edhe ajo që nuk është shkruar, që autori ka lënë pa thënë, por që merr jetë nga përvoja jonë artistike dhe jetësore. Këtu nënkuptohet koncepti i *metatekst* ose i tekstit të krijuar përmes perceptimit të tekstit të dhënë.

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja zhvillon aftësitë e domosdoshme për të realizuar punën kërkimore. Ai/ajo përzgjedh burime të ndryshme informacioni, të përshtatshme për kërkime, si dhe përdor informacionin për të mbajtur qëndrim ndaj një çështjeje të caktuar. Gjithashtu, vlerëson dokumente publike për logjikën, argumentet, paraqitjen e shqetësimeve të audiencës dhe për mënyrën sesi ia shtojnë interesin lexuesit. Nxënës/i,-ja arrin të krahasojë dy vepra, që janë të së njëjtës gjini, që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme. Zbulon ndryshimet dhe afëritë e dy veprave që nuk janë të së njëjtës gjini e të së njëjtës formë ligjërimi. Për të bërë kërkimin, ai/ajo zgjedh dhe përdor burime të ndryshme informacioni.

Linja	Objektiva
Kërkimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përzgjedhë burime të ndryshme informacioni, të përshtatshme për kërkime; - të vlerësojë cilësinë e informacionit të përzgjedhur nga autor/i,-ja e tekstit; - të krijojë materiale për një portofol (dosje) që tregon një drejtim të caktuar karriere; - të paraqesë punë me shkrim dhe me gojë, të cilat përmbledhin materiale të ndryshme; - të përdorë informacionin e marrë nga burime të ndryshme për një çështje të caktuar, për të ndërtuar një argument, për të nxjerrë përfundime ose për të mbajtur një qëndrim; - të vlerësojë logjikën, koherencën dhe vlefshmërinë e argumenteve në dokumente publike - të vlerësojë shkallën në të cilën këto dokumente paraqesin shqetësimet e lexuesve; - të vlerësojë mënyrën si paraqiten dhe shtojnë interesin këto dokumente, në audienca të ndryshme; - të nxjerrë përfundime me shkrim dhe me gojë, duke u bazuar në të dhënat e marra nga tekste të ndryshme; - të krahasojë dy vepra, që janë të së njëjtës gjini, që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme; - të krahasojë dy vepra, që nuk janë të së njëjtës gjini, të së njëjtës formë ligjërimi, për të zbuluar ndryshimet dhe afëritë.

TË SHKRUARIT

Linja 1. Shkrimi si proces

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e procesit të shkrimit. Ai/ajo realizoi hapat e përcaktuara dhe të domosdoshme për këtë proces. Nxënës/i,-ja përdori strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij/saj, vlerësoi cilësinë e një informacioni për ta përdorur më pas në shkrimin e tij/e saj, si dhe reflektoi ndaj shkrimit duke vendosur objektiva për përmirësim. Procesi i të shkruarit realizohet në shkrime të llojeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Shkrimi si proces	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit: parashkrimi, draftimi, (shestimi), rishikimi (redaktimi e korrektimi), shkrimi e dorëzimi duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë; - të përcaktojë temën për të cilën shkruan; - të përdorë strategji të larmishme (brainstorm-i, shkrimi i lirë, kllasteri, diagrami i Venit) për të planifikuar shkrimin e tij/saj; - të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin, këndvështrimin, organizimin, koherencën (rrjedhën logjike) dhe qartësinë e mendimit; - të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, nënidetë, organizimi, drejtshkrimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij/ e saj dhe të tjerëve; - të vlerësojë cilësinë e një informacioni për ta përdorur më pas në shkrimin e tij/e saj; - të reflektojë ndaj shkrimit të tij/të saj duke vendosur objektiva për përmirësim; - të mbledhë informacione nga burime të ndryshme për qëllime të caktuara; - të përdorë (të shfrytëzojë) mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar.

Linja 2. Shkrimi si produkt

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e konceptit të shkrimit përfundimtar si produkt që lexohet nga një audiencë e gjerë. Ai/ajo përdori elementet e domosdoshme për të përfunduar një shkrim: drafton (skicon/harton/ sheston) ide, shkruan paragrafë, hyrje dhe mbyllje duke përdorur stil vetjak dhe duke zbatuar kriteret gramatikore e drejtshkrimore për një produkt cilësor. Për të realizuar këto, nxënës/i,-ja ushtrohet në veprimtari praktike dhe paraqet produkte të formave të shkrimeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Shkrimi si produkt	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë karakteristikat, strukturat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme për t'i përdorur këto njohuri në shkrimet e veta; - të draftojë (skicojë/hartojë/ shetojë) një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim të mirë të formës; - të shkruajë tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore; - të vlerësojë tekste të publikuara për origjinalitetin dhe besueshmërinë e tyre; - të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive të tilla, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike (fakte, dokumente etj.), përshkrime, anekdota, shembuj dhe lloje të ndryshme shënimesh, si: shpjeguese, dedikimi, epigrami; - të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore; - të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara e në përputhje me synimin e të shkruarit; - të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, shembuj, përkufizim, analogji; - të përdorë burimet e <i>para</i> dhe të <i>dyta</i> për të paraqitur të dhëna, justifikime ose qëndrime duke cituar burimet nga librat, periodikët, burimet elektronike etj.; - të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm; - të zgjedhë pjesë të shkruara nga dosja individuale për të prezantuar arritjet e tij/e saj në zhanre të ndryshme; - të zgjedhë fjalët dhe format gjuhësore për të shprehur ngjyrimet emocionale personale etj.; - të përdorë stil vetjak dhe autorial për të tërhequr vëmendjen e audiencës; - të përdorë drejt kuptimet e <i>para</i> dhe të <i>dyta</i> të fjalëve; - të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit; - të përdorë struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj. në shkrimin e tij/e saj; - të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse në tekste të ndryshme.

Linja 3. Format e shkrimit, audiencia dhe qëllimet

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të shkruar në forma të ndryshme, për një shumëllojshmëri audiencash dhe qëllimesh. Krahas shkrimit të eseve, ai/ajo shkruan tekste vlerësuese, poetike e tregimtare, si dhe bën shkrime të tjera për nevoja vetjake, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për çdo (formë).

Linja	Objektiva
Format e shkrimit, audiencia dhe qëllimet	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë tekste bindëse /argumentuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme; - të shkruajë një studim kërkimor që sintetizon dhe citon të dhëna, duke përdorur informacione të marra për të mbështetur shkrimin e tij/saj; - të shkruajë tekste informative, si: CV, aplikim për punë; - të shkruajë tekst poetik, bazuar mbi modele të njohura apo që i merr për herë të parë duke ndjekur stilin e autorit; - të shkruajë tekste dramatike; - të shkruajë tekste eseistike; - të shkruajë tekste vlerësuese (kritike); - të bëjë ripunimin e një eseje; - të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat: <ul style="list-style-type: none"> ▪ zhvillojnë një ide, ▪ kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin, ▪ përfshijnë informacione të rëndësishme, duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme, ▪ bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike, ▪ mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura, ▪ paraqesin përfundime koherente. - të zbatojë të gjitha ligjet e të drejtës së autorit/autores ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim; - të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën elemente të tilla, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi; - të interpretojë efektin e përgjithshëm të veprës tek lexuesi; - të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën në shkrimin e tij.

Linja 4. Drejtshkrimi dhe pikësimi

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e rregullave drejtshkrimore, të pikësimit dhe të njohurive të gjuhës standarde shqipe. Ai/ajo i përdor

këto njohuri në shkrimet e tij si dhe në procesin e redaktimit. Nxënës/i,-ja përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit.

Linja	Objektiva
Drejtshkrimi dhe Pikësimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj; - të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve; - të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj; - të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve; - të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore të tilla, si: fjalor shpjegues, sinonimik, enciklopedik, terminologjik, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim; - të përdorë lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të përforcuar zhvillimin logjik.

TË FOLURIT

Linja 1. Diskutimi

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të marrë role të ndryshme në një diskutim, si p.sh.: të moderatorit, si dhe role drejtuese në projekte e forume. Ai/ajo modifikon një pozicion të caktuar në diskutimet në grupe dhe vlerëson përfundimet e një diskutimi. Nxënës/i,-ja merr nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi, duke parashtruar argumente me një përmbajtje të ngjeshur dhe brenda kohës së përcaktuar.

Linja	Objektiva
Diskutimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbajë një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup; - të luajë rolin e moderatorit në një diskutim; - të modifikojë një pozicion në diskutime që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha; - të paraqesë alternativën personale mbi çështjen a tekstin e caktuar; - të marrë role drejtuese në projekte dhe forume; - të vlerësojë përfundimet e një diskutimi; - të marrë nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi; - të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime,

	<p>audiencia, situata dhe kontekste të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të respektojë kërkesën për një përmbajtje të ngjeshur duke marrë parasysh faktorin kohë; - të parashtrijë argumentin përmes një përmbajtjeje të ngjeshur, duke respektuar faktorin kohë; - të shprehë një mesazh koherent; - të marrë parasysh rolin e audiencës, e qëllimit, e situatës dhe të kontekstit në një diskutim; - të shfrytëzojë pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij/saj në diskutime në grupe të vogla e të mëdha.
--	--

Linja 2. Hetimi dhe kontributi

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të hetuar informacionin dhe për të kontribuar në diskutime që bëhen në grupe të vogla dhe të mëdha. Ai/ajo bën pyetje dhe i përgjigjet audiencës, merr pjesë aktive dhe zgjeron diskutimet duke i pasuruar dhe duke i ilustruar me mendime vetjake. Nxënës/i,-ja jep udhëzime, përdor saktë elementet verbale dhe joverbale në komunikimin gojor, si dhe vlerësom në mënyrë kritike qëndrimin ose këndvështrimin e autorit. Gjithashtu, vlerëson dhe modifikon punën në grup. Për të hetuar e kontribuar në diskutime, nxënës/i,-ja ushtrohet në veprimtari praktike për tema të fushave të ndryshme.

Linja	Objektiva
Hetimi dhe kontributi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme; - t'u përgjigjet pyetjeve të audiencës duke dhënë sqarime, ilustrime, përkufizime dhe plotësime; - të diskutojë tekste letrare për të zbuluar dhe zhvilluar tema të ndryshme; - të zgjerojë diskutimet duke i pasuruar dhe duke i ilustruar me mendime vetjake; - të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutime të llojeve të ndryshme për të ndarë me të tjerët mendimet e tij/saj; - të parafrzojë komente të prezantuara me gojë nga të tjerët, për të sqaruar këndvështrimin e tyre; - të japë udhëzime për të kryer detyra specifike, për t'iu përgjigjur pyetjeve ose për të zgjidhur probleme; - të vlerësojë në mënyrë kritike qëndrimin ose këndvështrimin e autorit; - të përdorë saktë elementet verbale dhe joverbale në komunikimin gojor; - të marrë parasysh faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta, këndvështrimi etj.)

	<p>që ndikojnë në ndërtimin e mesazhit të tij/saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të modifikojë punën në grup; - të vlerësojë punën në grup; - të zotërojë aftësitë e domosdoshme për të prezantuar mesazhin; - të përdorë elemente të gjuhës së gjesteve, të domosdoshme për të prezantuar mesazhin; - të vlerësojë praninë dhe rolin e varianteve letrare: toskërisht, gegnisht dhe arbërisht, në një tekst letrar; - të marrë parasysh rolin e vlerësimit në komunikimin gojor.
--	--

Linja 3. Zgjedhja e fjalëve

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e përzgjedhjes së fjalëve të përshtatshme dhe ndikuese për të sqaruar idetë në një komunikim gojor. Ai/ajo përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme.

Linja	Objektiva
Zgjedhja e fjalëve	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zgjedhë fjalët e duhura për të ruajtur tonin e përshtatshëm në diskutime e prezantime me gojë; - të zgjedhë fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e prezantime me gojë; - të përmirësojë zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjetet retorike dhe të figurshme.

Linja 4. Prezantimi me gojë

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e domosdoshme për të realizuar një prezantim gojor. Ai/ajo përdori strategjitë efektive për të përcjellë një mesazh gojor duke respektuar faktorin kohë. Nxënës/i,-ja redaktonte drafte të fjalimeve dhe përpunoi prezantimin gojor për të orientuar audiencën, si dhe vlerësoi prezantimin e tij/e saj gojor për ta përmirësuar atë.

Linja	Objektiva
Prezantimi me gojë	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të prezantojë në mënyrë individuale për një çështje/temë, që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara; - të prezantojë në grup për një çështje/temë të caktuar, që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara;

	<ul style="list-style-type: none"> - të përdorë një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagramë, grafikë, kllaster); - të demonstrojë strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm); - të respektojë faktorin kohë në prezantimet me gojë; - të përpunojë prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën; - të redaktojë drafte⁵ të fjalimeve në mënyrë të pavarur (individuale) dhe në grupe; - të vlerësojë prezantimin e tij/e saj gojor për ta përmirësuar atë.
--	---

TË DËGJUARIT

Linja 1. Të dëgjuarit e qëllimshëm

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e domosdoshme për të dëgjuarit e qëllimshëm. Ai/ajo përqendrohet tek folësi, për të identifikuar të dhënat kyç të një teksti të dëgjuar. Gjithashtu, dallon retorikat gojore bindëse nga ligjërimet e thjeshta gojore. Për të realizuar këto, nxënës/i,-ja merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon për tema të fushave të ndryshme.

Linja	Objektiva
Të dëgjuarit e qëllimshëm	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përqendrojë vëmendjen në mënyrë të përgjegjshme mbi folësin ose mesazhin; - të zgjerojë me gojë idetë e dëgjuara; - të mbajë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - të bëjë pyetje të përshtatshme që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - të identifikojë të dhënat kyç të një teksti të dëgjuar; - të bëjë dallimin ndërmjet retorikave gojore bindëse dhe emotive; - të zbulojë kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; - të tregojë sesi zgjedhja e fjalëve dhe e gjesteve zbulojnë qëllimin e folësit.

Linja 2. Të dëgjuarit për të reflektuar

⁵ draft – teksti jo në variantin përfundimtar, shkrimi paraprak i një teksti .

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja zotëron aftësitë për të reflektuar ndaj informacionit të dëgjuar. Ai/ajo rikujton përmbajtjen e informacionit të dëgjuar, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose ligjërate mbështet a kundërshton domethënien ose qëllimin e saj. Nxënës/i,-ja reflekton mbi informacione të llojeve dhe fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat.

Linja	Objektiva
Të dëgjuarit për të reflektuar	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor; - të vlerësojë besueshmërinë e folësit; - të përcaktojë rastet kur përdoret propaganda apo argumenti në komunikimin gojor; - të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat; - të zbatojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; - të rikujtojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; - të parafranojë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët; - të përmbledhë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët; - të analizojë mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose ligjërate mbështet a kundërshton domethënien ose qëllimin e saj.

TË VËSHTRUARIT

Linja 1. Ndërtimi i domethënies/kuptimit nga forma të ndryshme mediatike
Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e elementeve përbërëse të një mesazhi pamor dhe gojor. Ai/ajo i përdori këto njohuri për të shpjeguar mënyrën sesi fjalët, tingujt dhe imazhet përcjellin një mesazh, si dhe për të vlerësuar mesazhet mediatike si përfaqësime të realiteteve sociale dhe kulturore që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme. Krahason forma të ndryshme mediatike për të zbuluar anë të përbashkëta dhe dalluese për mënyrën e trajtimit të temave të njëjta.

Linja	Objektiva
Ndërtimi i domethënies/kuptimit nga forma të ndryshme mediatike	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zgjedhë format mediatike të përshtatshme për qëllimin e lexuesit; - të zbulojë veçori të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet mesazheve pamore e të shtypura; - të shpjegojë mënyrën sesi fjalët, tingujt dhe imazhet përcjellin një mesazh;

	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë aspekte të tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit; - të shpjegojë se mesazhet mediatike përcjellin përfaqësime të realiteteve sociale dhe kulturore që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme; - të vlerësojë si një produkt mediatik shpreh vlerën e kulturës që e prodhon; - të vlerësojë se mesazhet mediatike janë përfaqësime të realiteteve sociale dhe kulturore që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme; - të analizojë aspekte të tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit; - të shpjegojë përdorimin e fjalëve, tingujve e imazheve statike dhe të lëvizshme, në mesazhe të ndryshme mediatike, për qëllime të ndryshme; - të zbulojë anë të përbashkëta dhe dalluese për mënyrën si forma të ndryshme mediatike (gazeta, radioja, televizioni, interneti etj.) shtjellojnë tema të njëjta.
--	--

Linja 2. Mesazhet pamore dhe verbale

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e teknikave pamore në një mesazh mediatik. Ai/ajo identifikon dhe analizon media të ndryshme për stereotipe të ndryshme nëpërmjet teknikave pamore të mësuara.

Linja	Objektiva
Mesazhet pamore dhe verbale	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë stereotipe gjinore, etnike etj. në media të ndryshme; - të analizojë media të ndryshme për stereotipe gjinore, etnike etj.; - të analizojë teknikat pamore (ngjyra, zmadhim/zvogëlimi, këndvështrimi, përzgjedhja e detajeve) në mesazhe të ndryshme mediatike, të përdorura për një audiencë të caktuar; - të vlerësojë efektivitetin e teknikave pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar; - të zbulojë të përbashkëta dhe të veçanta të tri ose më shumë burimeve mediatike që ndikojnë tek mesazhi; - të gjejë elemente që ndikojnë te mesazhi në një burim

	<p>mediatik;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë përparësitë dhe mangësitë e reklamimit pamor dhe gojor; - të vlerësojë besueshmërinë e përmbajtjes së mesazheve të ndryshme mediatike; - të krijojë rubrika vlerësimi për të gjykuar efektivitetin e mesazheve gojore dhe pamore; - të zbulojë kuptimet që fshihen pas imazheve mediatike. - të gjejë veçori të përbashkëta dhe dalluese midis formave të ndryshme mediatike, p.sh.: filmi dhe versioni i tij në libër.
--	---

Linja 3. Informimi nga mediat e ndryshme

Përshkrimi i linjës. Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e përdorimit të burimeve të ndryshme mediatike (radio, televizion, internet) për t'u informuar për qëllime të caktuara. Ai/ajo identifikon format, teknikat dhe teknologjitë e përdorura në mesazhe, identifikon ndikimet politike e kulturore, ekonomike e sociale dhe diskuton rreth tyre.

Linja	Objektiva
Informimi nga mediet e ndryshme	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë tekste të medieve të shtypura dhe elektronike për të zbuluar marrëdhëniet njerëzore, idetë dhe aspektet kulturore; - të diskutojë për ndikimet politike e kulturore, ekonomike e sociale në media të ndryshme; - të identifikojë format, teknikat dhe teknologjitë e përdorura në mesazhe dhe paraqitje të ndryshme mediatike; - të vlerësojë forma të ndryshme mediatike, si p.sh.: televizionin, videon, lojërat, muzikën dhe filmin për të kuptuar përshtatshmërinë e mesazhit me audiencën, qëllimin e kontekstin; - të analizojë përmbajtjen e mesazheve mediatike në lidhje me efektin emocional që ka tek vështruesi; - të vlerësojë shpejtësinë, besueshmërinë dhe tipare të tjera multimediale në përthithjen e mesazhit mediatik; - të krijojë prezantime mediatike dhe raporte të shkruara që përdorin burime multimediale me imazhe, grafikë, muzikë, efekte tingujsh, të cilat paraqesin një këndvështrim të veçantë mbi çështjen.

5. TABELA⁶ E KËRKESAVE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjuha shqipe dhe letërsia	Matematika
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: - të përdorë tabela, grafikë dhe diagrame të thjeshta rrethore dhe në shtylla për të prezantuar dhe interpretuar informacione të ndryshme me shkrim dhe me gojë.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Arti Pamor
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: - të interpretojë karakteristikat e veprave të artit pamor në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme kulturore; - të përdorë elementet dhe parimet e artit pamor për të shprehur emocionet e marra nga një tekst; - të zbulojë shenjat artistike.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Gjuha e huaj
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: - të përdorë leksikun e gjuhës së huaj për të shpjeguar etimologjinë e fjalëve me prejardhje të huaj. - të përdorë leksikun e fjalëve të gjuhës shqipe për të shpjeguar kuptimin e fjalëve të huaja.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Teknologji
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: - të shkruajë në Word tekste të llojeve të ndryshme; - përdor programin Power Point për të bërë prezantime të ndryshme; - të përdorë internetin për të nxjerrë informacione të ndryshme; - të ndërtojë tabela, grafikë, diagrame të thjeshta për të përpunuar e prezantuar informacione të ndryshme; - të përdorë mjete të ndryshme elektronike, si: kompjuter, magnetofon, diktofon, video për qëllime të ndryshme.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Muzika
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit	Nxënës/i,-ja: - të interpretojë vepra të ndryshme muzikore të periudhave të ndryshme kohore; - të zbulojë vlerat e artit muzikor;

⁶ Tabela e kërkesave është hartuar për të tri vitet e shkollimit në gjimnaz.

Të vështruarit	- të vlerësojë efektet muzikore në një film a dokumentar, si mjete që ndihmojnë për të kuptuar domethënien e filmit a dokumentarit.
----------------	---

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për t'u zbatuar në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare, ku bën pjesë edhe kjo lëndë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduar.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- synimeve të linjave ndërkurrikulare;
- vlerësimin të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënie/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore e fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe të detyruara për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat.

P.sh.: Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë

Objekivi: Nxënës/i,-ja të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: *personazhet, temën, problemzgjidhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera*, nënkupton që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të ushtrohen në zbulimin e tipareve të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: *personazhet, temën, problemzgjidhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera*.

Nëse një mësues/e nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë

Objekivi: Nxënës/i,-ja të shkruajë tekste tregimtare për qëllime dhe audiencë të ndryshme, nënkupton që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të ushtrohen në

shkrimin e teksteve tregimtare, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel realizimi i tipit të shkrimit tregimtar.

Një nivel arritjeje është zbatimi i të gjithë hapave të domosdoshëm për shkrimin e një teksti tregimtar. Një nivel më i lartë se ky është cilësia e trajtimit të secilit nga hapat e lartpërmendur. Nëse të gjithë hapat do të zhvilloheshin sipas kërkesave të mësuara, atëherë do të kishim përbushjen e këtij objektivi në një nivel të lartë. Realizimi i objektivave në tema, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Objektivat e programit duhet të jenë të konkretizuar në tekste letrare dhe joletrare, të shkruara dhe jo të shkruara, të përshtatshme për moshën e nxënës/it,-es. Gjatë vitit shkollor, nxënës/i,-ja është i detyruar të lexojë 3-5 libra (vepra letrare ose joletrare, të gjinive të ndryshme, shqiptare dhe të huaja, të periudhave të ndryshme), krahas pjesëve që janë në përbërje të tekstit të gjuhës shqipe.

Sqarime mbi llojet e teksteve

Në përmbajtjen e programit përdoren termat: tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkrues, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik/kulturologjik, të cilët konkretisht do të nënkuptojnë:

- Tekstin tregimtar që tregon një ngjarje/histori të organizuar në prozë. Llojet e teksteve tregimtare mund të jenë imagjinare, të vërteta ose një kombinim i të dyjave, si p.sh.: tregime, fragmente romani, fragmente novele etj.
- Tekstin poetik që shpreh ndjenjat, mendimet, reflektimet etj. Llojet e teksteve poetike janë epike, lirike, liriko-epike.
- Tekstin dramatik në format e realizimit të tij: tragjedi, komedi, dramë, por edhe spektakli dhe skeçet.
- Tekstin bindës/argumentues që prezanton një argument dhe e mbron ose e kundërshton atë me të dhëna bindëse. Llojet e teksteve bindëse/argumentuese mund të jenë edhe të tipit ese.
- Tekstin përshkrues që përshkruan një person, vend, kujtim, përvojë a objekt. Llojet e teksteve përshkruese mund të jenë edhe të tipit ese.
- Tekstin shpjegues që shpjegon dukuri, çështje a tema të ndryshme. Llojet e teksteve shpjeguese mund të jenë: ese, receta, artikuj, dokumente qeveritare etj.
- Tekstin informativ që prezanton të dhënat e nevojshme mbi një çështje a temë të caktuar. Llojet e teksteve informative mund të jenë: memorandume, shënime, letra të llojeve të ndryshme, raportime, manuale etj.
- Tekstin eseistik që zakonisht e ndërthur shijen personale edhe me disa përfundime shkencore, por ku parësore është paraqitja bukur e mendimit.
- Tekstin kulturologjik në të cilin gërshetohen dhe shpalosen përvojat e shumta të dijeve dhe shkencave, klasike dhe moderne.

Në klasën e 12-të do të punohet me tekste përshkruese (ese), tekste shpjeguese (ese), tekste bindëse /argumentuese (ese), tekste informative (CV, aplikim për punë), tekste tregimtare (tregime, fragmente romani/novele), tekste poetike, tekste dramatike, tekste eseistike dhe kulturologjike që u përkasin drejtimeve dhe rrymave të ndryshme letrare.

Përballja me tekstin eseistik do ta ndihmonte nxënësin të bënte krahasimin me një tekst tjetër, p.sh.: argumentues/bindës apo përshkrues që mund të jenë të tipit ese. Po kështu, mund të themi se edhe tekste informative të tipit: aplikim për punë mund të krahasohen me aplikimin për shkollë, të mësuar në klasën e 10-të. Vendosija në nivele krahasimi do të ndihmonte nxënësin të zbulonte pikat e përbashkëta dhe dallimet mes tyre.

Pjesët duhet të jenë të përshtatshme për moshën e nxënësve dhe të përfshijnë vepra të shquara të letërsisë shqiptare (50%) dhe botërore (50%).

Kritere për përzgjedhjen e fragmenteve dhe veprave të detyruara

- Fragmentet e përdorura në tekstin e nxënësit të gjuhës shqipe dhe letërsisë duhet të realizohen në jo më pak se 3 orë (secila). Përveç kriterëve të përzgjedhjes së fragmentit, ai duhet të përmbushë objektiva të ndryshme për të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.
- Përdoruesit e programit janë të lirë të zgjedhin nga lista rekomanduese. Pjesët e përzgjedhura duhet të trajtohen në tekstin e nxënësit duke respektuar parimin gjinor, si dhe duke filluar nga krijimtaria e periudhës më të hershme. Kjo nuk do të thotë se përjashtohen rastet e “përballjes” së teksteve të periudhave të ndryshme, për të zbuluar dimensione kuptimore të caktuara mes tyre.
- Veprat e përzgjedhura si të detyruara për t’u trajtuar të plota duhet të realizohen në jo më pak se 6-7 orë secila. Edhe këto vepra, përveç kriterëve të përzgjedhjes duhet të përmbushin objektiva të ndryshme për të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.
- Përzgjedhja e veprave duhet të bëhet duke respektuar parimin gjinor, por edhe atë gjithëkohor dhe gjithëhapësinor, si dhe duke filluar nga krijimtaria e periudhës më të hershme. Ato nuk duhet t’i përkasin të njëjtës periudhë letrare.
- Është e detyrueshme që vepra e përzgjedhur të lexohet e plotë.
- Përdoruesit e programit duhet të pasqyrojnë në tekstin e nxënësit të gjitha veprimtaritë e domosdoshme për trajtimin e plotë të veprës.
- Tërësia e veprave dhe e fragmenteve të planifikuara në tekstin e nxënësit duhet të përmbushin të gjitha objektivat e programit.

Rekomandime

Për të përmbushur objektivat e lëndës, përdoruesit e programit mund të përzgjedhin vepra dhe pjesë nga autorët e mëposhtëm të letërsisë shqiptare dhe botërore, të periudhave të ndryshme.

Teksti poetik

Lirika antike greke dhe romake, Eposet mesjetare në kulturën e popujve të Evropës, Lasgush Poradeci “Vallja e Yjeve”/ “Ylli i zemrës”/ “Ekskursion i teologjik i Sokratit, Ernest Koliqi “Lirika”, Bujar Xhaferri “Lirika”, Migjeni “Vargjet e lira”, Martin Camaj “Njeriu më vete dhe me të tjerë”, “Nema”/ “Buellli”/ “Palimpsest”, Din Mehmeti “Klithmë është emri im”, Fatos Arapi “Gjeniu pa kokë”, Azem Shkreli “Lirikë me shi”,

Ali Podrimja “Poezi”, Besnik Mustafaj “Poezi”, Visar Zhiti” "Kujtesa e ajrit" / "Dyer të gjalla", Uiljam Blejk “Lirika”, Uolt Uitman “Fije bari”, Tomas S. Eliot “Katër stinët”/”Toka e shkretë”, Robert Frost “Poezi”, Irvin Allen Ginsberg “Poezi”, Pablo Neruda “Poezi”, Alen Boske “Lirika”, Gabriela Mistral “Poezi”, Xhuzepe Ungareti “Poezi”, Euxhenio Montale “Poezi”, Paul Éluard “Poezi”, Artur Rembo “Poezi”, Sharl Bodler “Lulet e së keqes”, George Seferis “Poezi”, Uilliam Batler Jits “Poezi”, Gjergj Fishta “Mrrizi i zanave”, Ismail Kadare “Ca pika shiu ranë mbi qelq”, Dritëro Agolli “Pelegrini i vonuar”, Sergej Esenin “Lirika”, Ana Ahmatova “Lirika”.

Teksti tregimtar

Fjodor Dostojevski “Krim dhe ndëshkim”, Xhejms Xhojs “Portret i artistit djalosh”, Franc Kafka” Procesi”/ “Metamorfoza”/ “Portat e ligjit”, Zhan Pol Sartër “Muri”, Alber Kamy “I huaji”, Dino Buxati “Shkretëtira e tartarëve”, Ernest Heminguej “Lamtumirë armë”/ “Për kë bien kambanat”, Boris Pasternak “Doktor Zhivago”, Ernesto Sabato “Tuneli”, Gabriel Garsia Markes “100 vjet vetmi”/ “Gjethurinat”/ “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”/ “Kolonelit nuk ka kush t’i shkruajë”, Hainrih Bëll “Nderi i humbur i Katerina Blumit”/ “Ku ishte ti Adam”/ “Kthim në shtëpi”, Hoze Saramago “Verbëria”, Doris Lessing “Fëmija i pestë”, Ferit Orhan Pamuk “Bora”, Mitrush Kuteli “E madhe gjëma e mekatit”, Ernest Koliqi “Vepra”, Migjeni “Novelat e qytetit të veriut”, Petro Marko “Nata e Ustikës”/ “Qyteti i fundit”, Anton Pashku “Oh”, Kasëm Trebeshina “Stina e stinëve”, / "Odin Mondvalsen" / "Fshati mbi shtatë kodrina" apo "Kënga shqiptare", Martin Camaj “Rrathë”/”Shkundullima”/ Pishtarët e natës”/ “Dranja”, Ismail Kadare: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”/ “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”/ “ Lulet e ftohta te marsit”/ “Darka e gabuar”, Dritëro Agolli “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”/ Njerëz të krisur, Fatos Kongoli “I humburi”/ “Te portat e Shën Pjetrit”/ “Lëkurë qeni”, Teodor Keko “Curriculum vitae”, Teodor Laço “Mjegullë”, Bashkim Shehu “Mozarti, me vonesë”, Mira Meksi “E kuqja e demave”, Kim Mehmeti “Vdekja e magjistares”.

Teksti dramatik

Uiliam Shekspir “Mbreti Lir”/ “Jul Qezari”/ “Tregtari i Venedikut”, Anton Santori “Emira”, Martin Camaj “Loja e mbasdrekës”, Teki Dervishi “Bregu i gjelbër”, Fan S. Noli “Izraelitë dhe filistinë”, Ethem Haxhiademi ”Abeli”, Kasëm Trebeshina “Drama”, Ismail Kadare ”Stinë e nxehtë në Olimp”, Anton Pashku “GoF” dhe “Sinkopa”, Luixhi Pirandelo “Drama”, Henrik Ibsen “Hijet”, Tenesi Uiliams “Macja mbi çatinë e nxehtë”, Zhan Pol Sartër “Duart e ndyra”/ “Me dyer të mbyllura”, Samuel Beket “Në pritje të Godosë”, Artur Miler “ Pamje nga Ura”, Bertold Breht “Arturo Ui”, Federico García Lorca “Drama”.

Teksti studimor, eseistik, ligjërime dhe kulturologji

Sami Frashëri, Faik Konica, Fan S. Noli, Mirash Ivanaj, Eqerem Çabej, Branko Merxhani, Ernest Koliqi, Tajar Zavalani, Mitrush Kuteli, At Zef Pllumi, Musine

Kokolari, Gjergj Fishta, Petro Marko, Ismail Kadare, Ali Aliu, Aurel Plasari, Jusuf Vrioni, Sabri Hamiti, Rexhep Qosja Nazmi Rrahmani, Agim Vinca, Vedat Kokona, Nasho Jorgaqi, Jorgo Bullo, Artan Fuga, Volter, Ruso, Stefan Cvajg, Alber Kamy, Tomas S. Eiot, Gertruda Stern, Artur Shopenhauer, Zigmund Frojd, Erih From, Jorge Luis Borges, Skot Pek, Leo Buskalja, Umberto Eco, Italo Kalvino, Roland Bart, Ardian Marashi, Injac Zamputi, Ibrahim Rugova, Floresha Dado, Kujtim Shala, Persida Asllani etj.

Lista nga do të përzgjidhen veprat e plota të detyruara:

Poezi

Lasgush Poradeci “Lirika”, Migjeni “Vargjet e lira”, Martin Camaj “Palimpsest”, Ismail Kadare “Ca pika shiu ranë mbi qelq”, Uolt Uitman “Fije bari”, Sharl Bodler “Lulet e së keqes”

Prozë

Alber Kamy “I huaji”, Gabriel Garsia Markes “100 vjet vetmi”, Ernest Koliqi “Vepra”, Martin Camaj, “Karpa”, Kasem Trebeshina “Odin Mondvalsen”, Ismail Kadare (kolana e veprave të zgjedhura).

Dramë

Uiliam Shekspir “Mbreti Lir”, Artur Miler “Pamje nga Ura”, Ethem Haxhiademi “Abeli”, Fan S. Noli “Izraelitë dhe filistinë”, Anton Pashku “Drama”.

Përkthyes të njohur (sipas renditjes alfabetike):

Aurel Plasari, Dritëro Agolli, Edmond Tupja, Edlir Hazizi, Fan Noli, Gjon Shllaku, Ismail Kadare, Lasgush Poradeci, Mira Meksi, Misto Treska, Mitrush Kuteli, Pashko Gjeçi, Pavli Qesku, Ardian Marashi, Robert Shvarc, Sotir Caci, Tajar Zavalani, Vedat Kokona etj.

Teksti tregimtar	15%
Teksti poetik	15%
Teksti dramatik	15%
Teksti bindës/argumentues	10%
Teksti përshkrues	10%
Teksti shpjegues	10%
Teksti informativ	5%
Teksti eseistik	10%
Teksti kulturologjik	10%

Punët me shkrim që duhet të realizojë nxënës/i,-ja i klasës së 12-të

Tekst informativ
Tekst poetik
Tekst dramatik
Tekst vlerësues (kritik)
Ese bindëse/argumentuese
Tekst eseistik
Ripunim eseje
Studim kërkimor

Produktet që duhet të vështrojë nxënës/i,-ja i klasës së 12-të

Reklama
Fotografia
Piktura
Skulptura

Prezantimet me gojë që duhet të realizojë nxënës/i,-ja i klasës së 12-të

Prezantime individuale

- Një prezantim individual për një çështje/temë⁷ që lidhet me koncepte dhe tema të trajtuara në tekstet e lexuara. (p.sh.: diskursi mitologjik në letërsinë e shekullit të 20-të).

Prezantime në grup

- Një prezantim për çështje a tema të caktuara⁸ që lidhen me koncepte dhe tema të trajtuara në tekstet e lexuara. (p.sh.: realizmi magjik në letërsinë shqipe (Kuteli dhe Koliqi); koncepti niçean i mbinjeriut tek poezia e Migjenit; nënteksti simbolik në prozën e Kadaresë; surrelizmi në prozëshkrimin e Trebeshinës, absurdi në dramtikën e Pashkut etj.)
- Një prezantim i llojit mediatic ku të përdoren burime multimediale: imazhe, grafikë, muzikë, efekte tingujsh, të cilat paraqesin një këndvështrim të veçantë mbi çështjen që trajtohet te materiali i shkruar.

Orët mësimore

Programi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë për klasën e 12-të është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia/mësimnxënia do të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor. Është e rëndësishme të theksojmë se brenda një ore mësimi duhet të realizohen: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit, të vështruarit, pra, ***nxënës/i,-ja do të ushtrohet për të pesë aftësitë brenda orës së mësimit***, pavarësisht se cila linjë do të ketë *peshë specifike* më të madhe.

⁷ Tema ose çështja për prezantim është mirë të caktohet nga nxënësi, pasi ai është mësuar të zgjedhë e të diskutojë tema. Nëse nxënës/i,-ja e ka të vështirë ta përzgjedhë temën, atëherë mund të ndihmohet nga mësues/i,-ja. Shembujt e dhënë janë vetëm për ilustrim, jo të detyruar.

⁸ I njëjti sqarim

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Një vend të rëndësishëm zë edhe përpunimi i njohurive.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë paraardhëse;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- projektin kurrikular lëndor;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë).
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Kritere specifike për vlerësimin në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë

- Mësues/i,-ja mund ta vlerësojë nxënës/in-en për aftësitë e të folurit dhe të të shkruarit për një larmishmëri audiencash dhe qëllimesh nëpërmjet disa mënyrash, si:
 - Ditari mësimor i nxënës/it,-es: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të qartësojë mendimet e të përgatitet për diskutimin në klasë, të zbatojë efektivisht elemente të procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë përdorimin efektiv të gjuhës, si dhe qëndrimet e nxënësve.
 - Diskutimi mbi një film/dokumentar: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike e gojore të nxënës/it,-es, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.

- Prezantimi me gojë: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të lexojë në mënyrë efektive dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë sesi ai/ajo sintetizon materialin e një teksti.
 - Shkrimi i esesë përshkruese: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të qartësojë mendimet e të përdorë efektivisht elementet e procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij/saj shkruese.
- Vlerësimin e aftësive për të lexuar, për të dëgjuar dhe për të vështruar materiale të formave të ndryshme mediatike, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke përdorur mënyra të tilla, si:
 - Lexim dhe diskutim në grup i një fragmenti: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të zhvillojë strategjitë e të lexuarit e të reflektojë ndaj tekstit. Gjithashtu, bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë strategjitë e të lexuarit dhe aftësitë reflektuese.
 - Shikim dhe diskutim në grup i një filmi/dokumentari: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike dhe gojore të nxënës/it,-es, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.
 - Vlerësimin e aftësive për të përzgjedhur përmes strategjive të ndryshme, për të kompletuar projekte individuale dhe në grup, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke përdorur mënyra të tilla, si:
 - Krijimi i rubrikës së vlerësimit: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të mendojë në mënyrë analitike e të njohë mirë standardet për realizimin e projekteve. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij/saj analitike, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen mbi standardet e kompletimit të një projekti.
 - Përcaktimi i temës së projektit: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të bëjë zgjedhje të kuptimshme dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë dhe arsyet e tij përzgjedhëse.
 - Vlerësimin e aftësive për të reflektuar mbi tekstin dhe për të mbajtur qëndrime, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke përdorur mënyra të tilla, si:
 - Shkrimi i esesë argumentuese: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të përdorë argumentet e të bëjë kërkime për t'i mbrojtur ato. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë logjikuere të nxënës/it,-es, si dhe përdorimin e informacionit të marrë nga tekstet e lexuara.
 - Debati mbi një temë të caktuar: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të ndërtojë dhe mbrojë qëndrimet e tij/saj me gojë. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij/saj, për të parashtruar mendimin dhe për ta mbrojtur atë.
 - Diskutimi në grup mbi qëllimin e autorit/autore: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të punojë me tekstin për të përcaktuar qëllimin e

autorit/autore dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë mendimin e tij/saj analitik, si edhe të dëgjuarit aktiv.

- Shkrimi i një letre zyrtare: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënës/in,-en të mbajë qëndrim mbi një çështje të mprehtë sociale, të vlerësojë informacione të marra nga burime të ndryshme dhe t'i sintetizojë ato në një letër drejtuar një institucioni. Gjithashtu, bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e nxënës/it,-es për të gjykuar vlefshmërinë, objektivitetin, cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit që ai/ajo lexon, dëgjon dhe vështron.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish a produktesh të tjera, si: shkruan, lexon, vlerëson, zbaton, analizon etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja duhet ta vlerësojë nxënës/in,-en jo vetëm për produktin përfundimtar, por për të gjitha hapat e procesit të të shkruarit.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për çdo orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtëklase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlikuar të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativa ose zhvillim, ese të llojeve të ndryshme, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij/saj, përgjatë vitit shkollor, për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, ese tematike, projekte kurrikulare, ese të llojeve të ndryshme etj. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësues/i,-ja, nxënës/i,-ja vetë dhe prindërit e tij/e saj gjejnë informacion të shpejtë dhe të përmbledhur rreth progresit të nxënës/it,-es. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh.: të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

8. PËRGATITJA PËR PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE (16 orë)

Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë është provim i detyruar i Maturës Shtetërore. Për këtë nxënës/i,-ja do t'i nënshtrohet një testimi, në përbërje të të cilit do të jenë konceptet, njohuritë dhe aftësitë e mësuarat në gjithë vitet e shkollimit. Për përgatitjen e nxënësve janë planifikuar 16 orë mësimore, të cilat do të realizohen në muajin e fundit të vitit mësimor.

Mësuesi është i detyruar t'i planifikojë këto orë vetëm për përgatitjen e provimit të Maturës Shtetërore.

Përgatitja për provimin e Maturës Shtetërore nuk është një proces i “izoluuar” në 16 orë mësimore, por ajo është e lidhur me gjithë periudhën e shkollimit. Kjo kërkon që çdo mësues:

- a) të zbulojë dhe të evidentojë arritjet e nxënësve;
- b) të planifikojë mbi bazën e arritjeve të tyre;
- c) të ushtrojë nxënësit në teste model.

a) Periudha parapërgatitore për provimin e Maturës Shtetërore duhet konceptuar si një fazë përmbyllëse e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë për arsimin e mesëm. Për të qenë një periudhë efikase, duhet që mësuesi të jetë i vëmendshëm gjatë procesit mësimor për të evidentuar arritjet e nxënësve, përpos të cilave do të planifikojë punën njëmuajore. Jo gjithçka mund të realizohet gjatë kësaj periudhe, ndaj kjo kohë duhet konceptuar si një fazë sistemimi dhe përforcimi të njohurive.

Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë, për mënyrën sesi është konceptuar, jep mundësi që në vijim të procesit mësimor të plotësohen hap pas hapi mangësi dhe probleme të vërejtura. Kështu, nëse konstatohet se nxënësit kanë vështirësi/mangësi, p.sh.: në *zbulimin e nëntekstit në një tekst poetik*, mësues/i,-ja dhe nxënësit kanë hapësira për të punuar me këtë element në tekstet në vijim. Fakti që nxënës/i,-ja përballet dhe ushtrohet në tekste të ndryshme, të shkruara ose jo të shkruara dhe mediatike, e bën më të lehtë “transferimin” dhe përdorimin e koncepteve, njohurive, aftësive edhe në tekste të tjera.

b) Është e domosdoshme që mësuesit të përgatitin një miniplan konkret dhe në përputhje me nevojat e nxënësve në lidhje me a) **të kuptuarit** dhe b) **të krijuarit** e teksteve të ndryshme, si: teksti tregimtar, poetik, dramatik, shpjegues, përshkrues, argumentues/bindës, informativ, teksti eseistik, si dhe forma të produkteve mediatike.

I. Në lidhje me **të kuptuarit** e teksteve të shkruara, vëmendja duhet të përqendrohet tek:
a) zbulimi dhe interpretimi i kuptimit të fjalës; b) njohja dhe përdorimi i strategjive të të lexuarit për qëllime të ndryshme, si: për të kuptuar tekstin, memorizuar informacionin dhe monitoruar procesin e të kuptuarit, për të bërë parashikime, për t'i rishikuar dhe verifikuar ato; c) parafrazimi dhe aftësitë organizuese për të përmbledhur informacionin pa ndryshuar idenë e autorit; d) zbulimi i teknikave që përdor autori për të mbështetur qëllimin e tij; e) zbulimi i karakteristikave të formës dhe të përmbajtjes së teksteve letrare dhe joletrare; f) analiza dhe interpretimi i gjuhës së përdorur në tekst; g) analiza e stilit të autorit; gj) zbulimi i nëntekstit; h) krahasimi i dy teksteve për të treguar të veçantat dhe të përbashkëtat; i) interpretimi i një vepre në drejtim të arritjes artistike e gjuhësore; zbulimi i qëndrimit të autorit; j) roli i fjalëve në krijimin e tonit dhe të atmosferës së veprës; k) zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, hiperonimia/hiponimia, fjalëshpejtat, shprehjet frazeologjike; l) konceptet letrare dhe efektet e tyre në domethënien e tekstit; ll) tiparet e përbashkëta dhe dallimet

midis teksteve të traditës letrare dhe shkrimeve bashkëkohore; m) analiza e dilemave njerëzore në tekste të ndryshme; nj) karakteri universal i tekstit etj.

Në lidhje me **të kuptuarit** e formave të ndryshme mediatike, vëmendja duhet të përqendrohet tek: a) zbulimi i veçorive të produkteve mediatike (reklamë, fotografi, pikturë, skulpturë); b) mënyra sesi fjalët dhe imazhet përcjellin një mesazh; c) analiza dhe vlerësimi i një produkti mediatik si vlerë e kulturës që e prodhon; d) krahasimi i produkteve të ndryshme mediatike, por që trajtojnë tema të njëjta; e) analiza dhe vlerësimi i teknikave pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar; f) zbulimi i nënkuptimeve që fshihen pas imazheve statike; g) analiza e një reklamimi pamor; gj) analiza e teknikave pamore (ngjyra, zmadhimi/zvogëlimi, këndvështrimi, përzgjedhja e detajeve) etj.

Formulimit i pyetjeve analitike, sintetizuese e vlerësuese, si dhe përgjigjja e tyre, është mjaft e rëndësishme në procesin e të kuptuarit të të gjitha llojeve të teksteve.

II. Në lidhje me **të krijuarit**, vëmendja duhet të përqendrohet tek: a) hapat e domosdoshëm të procesit të të shkruarit (parashkrimi, draftimi/shestimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi); b) përdorimi i strategjive të larmishme e të domosdoshme në planifikimin e një shkrimi; c) njohja dhe përdorimi i elementeve të sistemit të vlerësimit.

Gjithashtu, nxënës/i,-ja duhet të përdorë të gjitha elementet e domosdoshme për të përfunduar një shkrim të realizuar për një temë, për një qëllim e audiencë të caktuar. Rëndësi ka: a) draftimi i një ideje; b) shkrimi i paragrafëve me një stil vetjak dhe duke zbatuar kriteret gramatikore e drejtshkrimore për një produkt cilësor; c) forma e shkrimit duke zbatuar kriteret e domosdoshme sipas llojit.

Sigurisht që këto janë pika orientuese, pasi mësuesi planifikon mbi bazën e të dhënave të nxjerra, specifike për klasën.

d) Të ushtruarit në teste model, të ngjashme me formatin e provimit të Maturës Shtetërore, është i domosdoshëm, përpos të tjerave, edhe për të familjarizuar nxënësit me këtë format. Është mirë që nxënësit të punojnë të paktën një format testi të plotë, ku të përfshihen, veç pjesës së përmbajtjes, edhe rubrikat teknike që duhet të plotësojë nxënësi.

Programet orientuese të provimit të Maturës Shtetërore do të jenë një material më i hollësishëm për këtë problem.